



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 06.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 04.09.2023, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik “STONE GROUP” SH.P.K. & “Bashkimi Meti” sh.p.k, për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatrat Cërmjan ,Meqe”, Nr. i prokurimit- 632-23-6927-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-099 -521, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e** bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupt të Operatorëve Ekonomik “STONE GROUP” SH.P.K. & “Bashkimi Meti” sh.p.k e dt.04.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatrat Cërmjan ,Meqe”, Nr. i prokurimit- 632-23-6927-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-099 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 28.08.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Anullohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 28.08.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që lëndën ta kthej në ri-vlerësim;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.04.09.2023, Grup i Operatorëve Ekonomik “STONE GROUP” SH.P.K. & “Bashkimi Meti” sh.p.k, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatrat Cërmjan ,Meqe”, Nr. i prokurimit- 632-23-6927-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-099 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 06.09.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja janë pjesërisht të bazuara, prandaj Autoriteti Kontraktues, vendos që lëndën ta kthej në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës